



QKLL 2025

PRILL



AKTIVITETE TË QENDRËS KOMBËTARE TË LIBRIT DHE LEXIMIT

ALDA BARDHYLI – DREJTORE E QKLL

PËRGATITTI: DR. ANILA VOGLI MAKRI

10 PRILL 2025 – AKADEMIKU REXHEP QOSJA SHPALLET FITUESI I ÇMIMIT “LUMO SKËNDO” PËR VITIN 2024



Libri i tij “Për lirinë, të vërtetën dhe të drejtën” është vlerësuar si vepra më e mirë në lëmin e publicistikës dhe eseistikës.

23-25 PRILL 2025 / U ÇEL PANAIRI I 4-T MBARËKOMBËTAR I LIBRIT AKADEMIK DHE SHKENCOR

U hap Panairi i 4-t mbarëkombëtar i Librit Akademik dhe Shkencor, në Akademinë e Shkencave e Arteve të Kosovës. Ky panair është një nismë e përbashkët e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Akademisë së Shkencave e Arteve të Kosovës dhe realizohet në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare të Librit dhe Leximit.



21 PRILL 2025 / ÇMIMI “AT ZEF PLLUMI” 2025

Në ambientet e Bibliotekës Publike “Gjergj Fishta” u zhvillua ceremonia e ndarjes së Çmimit “At Zef Pllumi” 2025, një aktivitet që nderon kujtimin dhe veprën e një prej figurave më të ndritura të kulturës dhe shpirtit të lirë shqiptar.



2 PRILL 2025 / Dita Ndërkombëtare e LIBRIT PËR FËMIJË



14-15 prill 2025 / Në mbledhjen e 35-të të RRJETIT TRADUKI NË ZAGREB



20 PRILL 2025 / FESTIVALI SHQIPTAR I LETËRSISË – edicioni i parë



23 PRILL 2025 / Poetët për poetët. Aktivitet në kuadër të DITËS BOTËRORE TË LIBRIT





QKLL 2025

PRILL



AKTIVITETE TË QENDRËS KOMBËTARE TË LIBRIT DHE LEXIMIT

10 PRILL 2025 / AKADEMIKU REXHEP QOSJA SHPALLET FITUESI I ÇMIMIT “LUMO SKËNDO” PËR VITIN 2024

Libri i tij “Për lirinë, të vërtetën dhe të drejtën” është vlerësuar si vepra më e mirë në lëmin e publicistikës dhe eseistikës. Juria e kryesuar nga Belina Budini dhe me anëtarë Uran Butka, Anastas Angjeli, Rudina Xhunga, Aida Tuci e vlerësuan veprën publicistike të Rexhep Qosjes me motivacionin: “Përmes analizave të tij të mprehta dhe studimeve të thelluara mbi gjuhën shqipe, akademiku Rexhep Qosja ka dhënë një kontribut të çmuar në zhvillimin e mendimit kritik dhe në forcimin e vetëdijes kombëtare”.

10 finalistët e këtij edicioni ishin:

Rexhep Qosja me veprën “Për lirinë, të vërtetën dhe të drejtën”,

Pirro Loli me veprën “Unë jam një tjetër”;
Luan Rama me veprën “Udhë e gjatë në tunelin e Platonit”;

Bedri Islami me veprën “Kadare i oborrit apo i lirisë”;

Sherif Bundo me veprën “Dollia shqiptare”;
Arben Imami me veprën “Kushtetuta”;
Viola Isufaj me veprën “Baladë dritash për Zorbën”;
Edlira Cerkezi me veprën “Mitet dhe raporti me letërsinë artistike”;

Enis Sulstarova me veprën “Samiu dhe Utopia”;
Stefan Çapaliku me veprën “Post scriptum – studime kulturore”.


25 PRILL 2025 / Vizitë në shtëpinë e shkrimtarit dhe intelektualit të madh shqiptar, REXHEP QOSJA

Ambasadori i Shqipërisë në Kosovë Petrit Malaj bashkë me drejtoreshën e Qendrës Kombëtare të Librit dhe Leximit, Alda Bardhyli vizituan shtëpinë e shkrimtarit dhe intelektualit të madh shqiptar, Rexhep Qosja. Ambasadori Malaj i dorëzoi zotit Qosja Çmimin “Lumo Skëndo” për vitin 2024.

Akademiku Qosja u vlerësua me këtë çmim për veprën e tij “Për lirinë, të vërtetën dhe të drejtën”.

Juria e kryesuar nga Belina Budini dhe me anëtarë Uran Butka, Anastas Angjeli, Rudina Xhunga, Aida Tuci e vlerësuan veprën publicistike të Rexhep Qosjes me motivacionin: “Përmes analizave të tij të mprehta

dhe studimeve të thelluara mbi gjuhën shqipe, akademiku Rexhep Qosja ka dhënë një kontribut të çmuar në zhvillimin e mendimit kritik dhe në forcimin e vetëdijes kombëtare”.





QKLL 2025

PRILL



AKTIVITETE TË QENDRËS KOMBËTARE TË LIBRIT DHE LEXIMIT

2 PRILL 2025 / DITA NDËRKOMBËTARE E LIBRIT PËR FËMIJË

Të njihemi me autorët shqiptarë të letërsisë për fëmijë



Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Letërsisë për Fëmijë, Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare të Kulturës për Fëmijë organizoi një takim me tre autorët: Sonila Strakosha me librin për

fëmijë “Pse e përqeshin shoqet Martinën?”, Majlinda Leka me librin “22 lojëra (games)”, Ralf Spiro me librin “Antoku dhe ngjyrat e ylberit” dhe fëmijëve të QKKF-së ku autorët e pranishëm folën mbi librat e tyre dhe

rëndësinë e leximit të librave. Takimi u mbyll me lexime dhe lojëra mes fëmijëve, prindërve dhe autorëve.

11 PRILL 2025 / Shpallen 10 fituesit e përzgjedhur nga juria e FONDIT TË KRIJIMTARISË LETRARE PËR TË RINJ

Mbështetja e letërsisë së autorëve të rinj është një fokus i vazhdueshëm i punës për të inkurajuar krijimtarinë.

Fituesit janë autorët: Liza Brozi dhe Elvin Nuri, Ena Bulku dhe Arbër Selmani, Rea Shundi dhe Rejvi Dervishi, Xhentiana Muskaj dhe Thimi Gogo, Antonio Çikollari dhe Xhensila Dautllari.



14 PRILL 2025 / Në Kroaci, në përkujtim të arkitektit me famë ANDREA ALESSI

Andrea Alessi një prej figurave madhore të arkitekturës europiane me origjinë shqiptare, është kujtuar në një aktivitet organizuar nga Shoqata e Arkitektëve kroatë në Zagreb. Në

aktivitet folën Velimir Neidhardt, president i Akademisë së Arteve dhe Shkencave kroate, Drejtoresha e QKLL Alda Bardhyli, arkitektët Rilind Čočaj dhe Ardijan Karlo Gashi. Aktiviteti u shoqërua me një

eksponitë të veprave të Andrea Alessi-t, realizuar nga fotografi shqiptaro-kroat Luka Mjeda.



QKLL 2025

PRILL



AKTIVITETE TË QENDRËS KOMBËTARE TË LIBRIT DHE LEXIMIT

ALDA BARDHYLI – DREJTORE E OKLL

PËRGATITI: DR. ANILA VOGLI MAKRI



14-15 PRILL 2025 / Në mbledhjen e 35-të të rrjetit **TRADUKI** NË ZAGREB

Shqipëria ishte pjesëmarrëse në mbledhjen e 35-të të rrjetit Traduki që u mbajt nga datat 14-15 prill në Zagreb. Rritja e mbështetjeve mbi botimet dhe përkthimin e letërsisë shqipe në gjuhët e rajonit ishte pjesë e diskutimeve.

Rrjeti i përkthimit TRADUKI vepron prej 15 vjetësh në Ballkan. Me ndihmën e tij janë përkthyer mbi 900 libra. Në disa vende të rajonit, si në Shqipëri, ka vënë standarde të reja në marrëdhëniet me përkthyesit.



15 PRILL 2025 / **TAKIM NË BIBLIOTEKËN QENDRORE NË ZAGREB**

Libri shqip në Bibliotekat europiane, ishte aktiviteti që na bashkoi në Bibliotekën Qendrore në Zagreb. Biblioteka Qendrore e Shqiptarëve në Kroaci u themelua në vitin 1994, që nga atëherë ajo funksionon në kuadër të Bibliotekës “Bogdan Ogrizović” - Biblioteka e qytetit të Zagrebit. Prej vitesh Dori Kerni kujdeset për këtë hapësirë të rëndësishme të shqipe.





QKLL 2025

PRILL



AKTIVITETE TË QENDRËS KOMBËTARE TË LIBRIT DHE LEXIMIT

18 PRILL 2025 / VARGJE NË TELAJO.

EKSPOZITË NGA PIKTORI ORGES SHIJAKU



Librat që frymëzuan Sali Shijakun vijnë në një ekspozitë bashkë me tablotë e të birit, piktorit Orges Shijaku, si një komunikim brezash dhe idesh.

Mes këtyre krijimeve ndodhet edhe një vepër e të madhit Sali Shijaku, babait të Orgesit, si për të dëshmuar kontrastin e brezave. Hije të madhe lëshon emri i Sali Shijakut, por i biri sikur ka trashëguar sharmin, duke e çarë disi hijen, me dritën e ngjyrave të tij, pafund.

Në një cep të vogël të sallës, një ekspozat me libra të kujton Sali Shijakun, veprën e tij, kujtimin dhe madhështinë. Kryesisht janë vepra me ilustrime rreth punëve të tij, por edhe të pikturës botërore, ndonëse nuk mungojnë edhe disa botime të vjetra klasike të letërsisë botërore.

Orges Shijaku paraqiti përmes tablove larmi tematikash e frymëzimesh, nga portretet, peizazhet, nudot e stilizuara, apo mistere dhe enigma moderniste. Të gjitha të ngjajnë me vargje plot ngjyra e dritë të një poezie, të derdhur në tela. Kështu pëlqen dhe autori ta quajë ekspozitën e tij, duke shprehur dhe pasionin e tij të fshehtë për poezinë.



Qendra është shndërruar në një hapësirë ekspozimi ngjyrash, falë Orges Shijakut, që modestisht flet për krijimet e tij, shumë prej të cilave kanë parë edhe dritën e ekspozimit jashtë vendit, në Gjermani, apo Itali.

Modernizmi i Sali Shijakut duket se është trashëguar dhe mishëruar në krijimet e të birit, i cili nuk harron ta përmendë sa herë që sheh e komenton ndonjë vepër të vetën.

Ai premtim edhe pasurimin e ekspozitës (së shpejti) edhe me disa qeramika (dashuria e vërtetë e Orgesit) të cilat mbeten trashëgimi brezash e piktorëve të familjes Shijaku.

20 PRILL 2025 / FESTIVALI SHQIPTAR I LETËRSISË – Edicioni i parë



Fondacioni UET PRESS, në bashkëpunim me Hotel Princ, Bashkinë Lezhë, Universitetin Europian të Tiranës, Institutin Liberal Pashko dhe Akademinë e Studimeve Shqiptare, organizoi edicionin e parë të Festivalit Shqiptar të Letërsisë – një ngjarje e re kulturore në peizazhin letrar shqiptar.

Gjatë ditës së parë, autorë të njohur, kritikë letrarë, studiues dhe nxënës të shkollave të mesme nga rrethet letrare të vendit u mbledhën për të festuar letërsinë shqipe dhe për të diskutuar mbi zhvillimet më të fundit në këtë fushë.

Të ftuarit specialë përfshinë disa nga emrat më të njohur të letërsisë dhe të mendimit publik shqiptar: Vera Bekteshi, Natasha Lako, Virgjil Muçi, Preç Zogaj, Gani Mehmetaj dhe Dionis Prifti.



QKLL 2025

PRILL



AKTIVITETE TË QENDRËS KOMBËTARE TË LIBRIT DHE LEXIMIT



Në ditën e dytë të Festivalit Shqiptar të Letërsisë në fokus ishte workshop-i me temë: “Think Outside the Box / Edukimi & Industria Kreative – Skenari, Filmi, Letërsia, Reklama dhe Public Speaking”, mentoruar nga Dr. Elvida Sinaj, Psikologe dhe Pedagoge në UET dhe Dr. Ermir Nika, kritik letrar, pedagog në UET.

Ky aktivitet solli së bashku profesionistë dhe krijues nga fusha të ndryshme të industrisë kreative, të cilët ndanë përvoja dhe

reflektime mbi mënyrat sesi letërsia ndërthuret dhe komunikon me forma të tjera shprehjeje artistike dhe profesionale.

U diskutua mbi rolin e edukimit në formësimin e mendimit kritik dhe kreativ, si dhe mbi potencialin që ofrojnë skenari, filmi, reklama dhe të folurit në publik si mjete të fuqishme për të shprehur ide dhe për të ndërtuar rrëfime me ndikim.

Gjithashtu të ftuar në këtë ditë ishin disa nga figurat më të njohura të

letërsisë, mendimit dhe artit shqiptar si Besnik Mustafaj, Vera Bektashi, Ilir Ikonomi, Natasha Lako, Mimoza Ahmeti, Virgjil Muçi, Preç Zogaj, Luljeta Dano, Gani Mehmetaj dhe Dionis Prifti.

Përmes pranisë së tyre, diskutimi mori dimensione të thelluara mbi lidhjet mes fjalës së shkruar dhe formave të reja të komunikimit në një realitet gjithnjë e më të ndërlikuar dhe kërkues.

21 PRILL 2025 / ÇMIMI “AT ZEF PLLUMI” 2025



Në ambientet e Bibliotekës Publike e ndarjes së Çmimit “At Zef Pllumi” “Gjergj Fishta” u zhvillua ceremonia 2025, një aktivitet që nderon

kujtimin dhe veprën e një prej figurave më të ndritura të kulturës dhe shpirtit të lirë shqiptar.

Mes poezisë, muzikës dhe reflektimit, u përçua fryma e qëndresës dhe dashurisë për të vërtetën, vlera që At Zef Pllumi i mbarti me dinjitet.

Në aktivitet morën pjesë artistë, autorë dhe poetë nga mbarë vendi, në një prani domethënëse për përkujtimin e kësaj figure të madhe.

Çmimi i këtij viti iu dha autorit z. Ilir Konomi, për kontributin e tij të spikatur në letërsi dhe trashëgimi shpirtërore.



QKLL 2025

PRILL



AKTIVITETE TË QENDRËS KOMBËTARE TË LIBRIT DHE LEXIMIT



23 PRILL 2025 / Mbrëmje letrare - "FJALË KUNDËR HESHTJES - LETËRSIA MES IDEOLOGJISË DHE IDENTITETIT"

Qendra Goethe-Zentrum ftoi të pranishëm në mbrëmjen letrare "Fjalë kundër heshtjes - Letërsia mes ideologjisë dhe identitetit".

Autorët Lindita Arapi dhe Arian Leka bashkëbiseduan mbi marrëdhënien mes letërsisë,

ideologjisë dhe kërkimit të identitetit.

Takimi u moderua nga Marsela Roshi Likaj.



23 PRILL 2025 / POETËT PËR POETËT - Aktivitet në kuadër të ditës botërore të librit



Dita Botërore e Librit, është një festë globale që na kujton rëndësinë e leximit, forcën e fjalës së shkruar dhe ndikimin e pashtershëm që librat kanë në jetët tona.

Libri nuk është thjesht një grumbull fletësh të mbledhura bashkë. Është një udhëtim përmes mendimeve, ndjenjave dhe ëndrrave. Nëpërmjet librit, ne mund të udhëtojmë në kohë, të shëtisim në vende që kurrë s'i kemi parë dhe të përjetojmë histori që

na formojnë shpirtin dhe intelektin. Një libër mund të na japë njohuri, mund të na sfidojë të mendojmë ndryshe dhe mund të na ndihmojë të kuptojmë më mirë veten dhe botën që na rrethon.

Poetët për poetët, është aktiviteti që bëri bashkë për të kremtuar këtë ditë, duke festuar bukurinë e vargjeve shqipe.

Të pranishëm: Rita Petro, Mimoza Ahmeti, Rudolf Marku.



24 PRILL 2025 / TAKIM ME TË RINJTË E SHKOLLËS "NAIM FRASHËRI"

Dita Botërore e Librit u kremtua në ambientet e Qendrës Kombëtare të Librit dhe Leximit me të rinjtë e shkollës "Naim Frashëri".

Në këtë ditë feste për librin, më shumë se kurrë, kemi nevojë t'u japim fëmijëve dhe të rinjve dashurinë për librin. Një fëmijë dhe një i ri që lexon është një fëmijë që ëndërron, krijon dhe sfidon në të ardhmen.

Poetët e njohura, Mimoza Ahmeti dhe Rita Petro si dhe shkrimtari Pol Milo ndanë eksperiencat e tyre të shkrimit si dhe sa i rëndësishëm është libri dhe leximi për shoqërinë.

Poetja Mimoza Ahmeti u shpreh se ka libra, të cilët të hapin optikën e shikimit dhe ka të tjerë, të cilët na e verbojnë atë, siç ishin librat në kohën e komunizmit. "Lexuesi duhet të gjejë librin e mirë dhe ta përqafojë atë", tha ndër të tjera ajo.

Ndërsa, Rita Petro u shpreh se "në ditët e sotme ka shumë libra, por lexuesi duhet të shkojë dhe të gjej klasikët, pasi ata janë librat që e formësojnë, librat që e tronditin dhe një libër i mirë të trondit. Është e rëndësishme që të njihet dhe të ndiqet tradita, por njëkohësisht të bëhesh edhe ndryshimi, të kesh origjinalitetin tënd në të shkruar".



QKLL 2025

PRILL



AKTIVITETE TË QENDRËS KOMBËTARE TË LIBRIT DHE LEXIMIT

Takimi u shoqërua edhe me lexime nga poezitë e poetëve të shquar si: Lasgush Poradeci dhe Azem Shkreli.



23 - 25 PRILL 2025 / U ÇEL PANAIRI I 4-T MBARËKOMBËTAR I LIBRIT AKADEMIK DHE SHKENCOR. SHPALLET FITUESI

U hap Panairi i 4-t mbarëkombëtar i Librit Akademik dhe Shkencor, në Akademinë e Shkencave e Arteve të Kosovës. Ky panair është një nismë e përbashkët e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Akademisë së Shkencave e Arteve të Kosovës dhe realizohet në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare të Librit dhe Leximit. Nisur edhe nga tri edicionet e mëparshme të panairit, panairi shërben për ta nxjerrë më në pah botën akademike, shkencore shqiptare përmes botimeve, që në

pjesën më të madhe të rasteve nuk kanë pasur vëmendjen e duhur publike. Në kuadër të marrëveshjeve të përbashkëta ndërinstucionale me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë dhe Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës edhe këtë vit Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit mbështeti çmimin për “Veprën më të mirë studimore”, që u propozua nga Akademia e Shkencave të Shqipërisë dhe Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës.

Me çmimin për “Veprën më të mirë studimore” u nderua akad. Myzafere Limani për veprën “Akustika, të folurit dhe muzika” me motivacionin: “Me një aparat matematikor relativisht të thjeshtësuar, libri paraqet burim të pasur dhe të besueshëm të informacioneve edhe për studiuesit dhe ekspertët e fushave të tjera që ndërlidhen me akustikën, sinjalet e të folurit dhe muzikën”.

PANAIRI MBARËKOMBËTAR I LIBRIT AKADEMIK DHE SHKENCOR

(EDICIONI IV)

23-25 PRILL 2025
NË MJEDISËT E AKADEMISË PRISHTINË

HAPJA NË ORËN 10:00





QKLL 2025

PRILL



AKTIVITETE TË QENDRËS KOMBËTARE TË LIBRIT DHE LEXIMIT

ALDA BARDHYLI – DREJTORE E QKLL

PËRGATITI: DR. ANILA VOGLI MAKRI

24 PRILL 2025 / MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI MES QENDRËS KOMBËTARE TË LIBRIT DHE LEXIMIT DHE FAKULTETIT FILOZOFIK TË UNIVERSITETIT TË PRISHTINËS

U nënshkrua marrëveshja e bashkëpunimit mes Qendrës Kombëtare të Librit dhe Leximit dhe Fakultetit Filozofik të Universitetit të Prishtinës, e cila ka si qëllim rritjen e bashkëpunimit mes institucioneve në fushën e kërkimit shkencor, edukimit dhe kulturës. Marrëveshja u nënshkrua nga drejtoresha e Qendrës Kombëtare të Librit dhe Leximit, Alda Bardhyli

dhe nga Dekani i Fakultetit Filozofik në Universitetin e Prishtinës, Bekim Baliqi në mjediset e Fakultetit në Prishtinë. I pranishëm ishte dhe ambasadori i Shqipërisë në Kosovë, Petrit Malaj, akademik Muhamet Mala, prodekanët Arsim Sinani, Bardhok Bashota, studentë, profesorë etj. Kjo marrëveshje premtoi aktivitete, konferenca dhe seminare të përbashkëta mes dy

institucioneve përgjatë vitit 2025, e tutje. Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit dhuroi edhe 70 tituj librash të autorëve bashkëkohorë shqiptarë për Bibliotekën e Fakultetit Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Ky akt u nënshkrua në vigjilje të 65-vjetorit të njësisë më të vjetër akademike, Fakultetit Filozofik të Universitetit të Prishtinës.

